



Pranimi / Dorezuar Prilipim / Prigadato Received / Delivered	13.10.2022	2	vit year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKPMSPK/6135/2022	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.746/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabanu-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.746/2022 të datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga kundër Vendimit me Nr.01-112/02-0084042/22 të datës 01.08.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Pejës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.746/2022 e datës 30.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, përmes e-mailit më datë 30.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër:5028/2022, kundër Vendimit me Nr.01-112/02-0084042/22 të datës 01.08.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Pejës, ndërsa Këshilli më datë 21.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:5028/2022 të datës 30.08.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga F.F. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 30.08.2022; Formulari i Regjistrimit të Ankesës F.F.; Letërnjoftim i preliminarë të verifikimit paraprak të kandidatëve, Grupi Specialist i Administrimit të Përgjithshëm i datës 15.06.2022; Rezultati përfundimtar për konkursin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm Inspektor Komunal dhe i Tregut i datës 26.07.2022; Ankesë e ankueses drejtuar Komisionit të Pranimit e datës 28.07.2022; Njoftim përmes e-mailit për F.F. i datës 04.08.2022; Vendim me Nr. protokoll 01-112/02-0084042/22 i datës 01.08.2022; Njoftim nga Udhëheqësi i personelit E.SH. i datës 08.08.2022; Plotësim i Ankesës i ankueses Nr.Prot:5065/2022 të datës 01.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pliko me nr. R2254631 i datës 30.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 21.09.2022; Aplikacioni i F.F. i datës 03.06.2022; Diplomë e F.F. nga Universiteti "Haxhi Zeka" me nr. 0039 i datës 02.07.2015; Diplomë e F.F. nga Kolegji Evropian Juridica me nr. D-34/2014 i datës 10.10.2014; Diplomë e F.F. nga Universiteti "Hasan Prishtina" e datës 29.03.2017; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar e F.F. e datës 01.07.2021; Vërtetim nga Avokati O.L. për F.F. i datës 15.01.2015; Certifikatë nga Gjykata e Apelit të Kosovës për F.F. e datës 16.04.2015; Vërtetim nga Oda e Avokatëve të Kosovës për F.F. me nr. 1325/16 i datës 18.10.2016; Vërtetim nga Avokatja Q.L. për F.F. i datës 10.05.2017; Vërtetim nga MBPZHR AZHB për F.F. i marrëdhënies së punës me nr. ref:07/04/296/2019 i datës 05.07.2019; Konkurs me emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm në komunën e Pejës për pozitën "Inspektor Komunal" dhe "Inspektor i Tregut" me nr. Reference RN00009006 i datës 12.05.2022; Vendim për Formimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil në Komunën e Pejës me nr. protokoll 01-112/02-0066904/22 i datës 21.06.2022; E-mail nga F.F. për P.B. i datës 04.08.2022; Fletë dorëzimi i F.F. i datës 04.08.2022; Procesverbal i datës 08.08.2022; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; E-mail nga A.U. për M.L.G. etj. i datës 20.07.2022; Rezultati përfundimtar për konkursin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm "Inspektor Komunal" dhe "Inspektor i Tregut" i datës 12.08.2022; Rezultatet e vlerësimit nga SIMBNJ për F.F.; Totali i pikëve nga SIMBNJ; Pliko me nr. R2454611 i datës 21.09.2022; E-mail nga E.SH. për C.Z. i datës 06.10.2022; E-mail nga C.Z. për E.SH. i datës 06.10.2022; Akt Emërim i P.B. me nr.01-112/01-0077941/22 i datës 18.07.2022; Akt Emërim i H.G me nr. 01-112/01-0047050/22 i datës 10.05.2022; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i K.S. me nr. 01-112-108129/1 i datës 12.07.2017; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i A.H. me nr. 02-200-115180 i datës 08.09.2015; Marrëveshje e D.K. me nr. 01-112/01-0057700/22 i datës 31.05.2022; Akt Emërim i A.U. me nr. 01-112/01-0093474/21 i datës 02.09.2021; Akt Emërim i A.G. me nr. 01-112/01-0099763/21 i datës 16.09.2021; Aktvendim konfirmim i Akt Emërimit nr.02-112/01-0036984/20 të datës 06.04.2020 për i datës 07.04.2021; Akt Emërim i H.H. me nr.01-112-195 i datës 04.01.2012; E-mail nga për i datës 04.08.2022; E-mail nga P.B. për F.F. i datës 04.08.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar , *sepse*:

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja ka qenë pjesë e procedurës së rekrutimit të shpallur sipas konkursit me numër reference: RN00009006 për emrin e grupit "Specialist i Përgjithshëm" për pozitën e punës "Inspektor Komunal dhe Inspektor i Tregut" të shpallur nga Komuna e Pejës dhe në testin me shkrim ka arritur të grumbulloi 50 pikë,



ndërsa e njëjta e pakënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit me datë 28.07.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit, me pretendimet ankimore të shkeljeve procedurale gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit, vlerësimin jo të drejtë të gjendjes faktike nga ana e komisionit të rekrutimit, shkeljeve materiale me rastin e themelimit të Komisionit të Pranimit me kërkesën për anulimin e konkursit.

Komisioni i Pranimit përmes vendimit të datës 01.08.2022 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses duke ndryshuar vlerësimin paraprak të jetëshkrimit nga 9.6 në 11 pikë dhe duke ia mundësuar pjesëmarrjen në fazën tjetër të rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës është konstatuar se Njësia e Pranimit me datë 04.08.2022 e ka njoftuar ankuesen për korigjimin e gabimit, gjegjësisht e ka ftuar ankuesen të marr pjesë në intervistën me gojë me datë 08.08.2022.

Ankuesja, sipas Njoftimit të datës 08.08.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës nuk ka marr pjesë në intervistën me gojë, ndërsa e njëjta kundër vendimit të Komisionit të Pranimit të datës 01.08.2022 sipas këshillës juridike ka parashtruar ankesë me datë 30.01.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave materiale në themelimin e komisionit të vlerësimit, shkeljeve procedurale nga komisionit i vlerësimit dhe vlerësimit jo të drejtë të gjendjes faktike.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë së shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me procedurën e rekrutimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”*.

Andaj, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurrimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje”* ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 30.08.2022 në Këshill është e palejueshme në këtë fazë të procedurës së rekrutimit, pasi që vlerësimi i jetëshkrimit nuk është dhe nuk mund të llogaritet si akt i përfundimit të procedurës së rekrutimit.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja nuk ka marr pjesë në intervistën me gojë sipas ftesës dhe njoftimit të datës 04.08.2022, respektivisht nuk është dëshmuar me asnjë provë se ankuesja të ketë parashtruar ankesë kundër aktit të përfundimit të procedurës së rekrutimit për vlerësimet e kandidatëve eventual fitues, nëse eventualisht ka përfunduar procedura në kuptim të nenit 25 paragrafit 1 dhe 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“1.*

Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj; 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”.

Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankuesit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shtruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”* ankesa e ankueses vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës, pasi që vlerësimi jetëshkrimi nuk llogaritet akt i përfundimit të procedurës së rekrutimit, rrjedhimisht ankuesja mundet ose është dashur që tek pas përfundimit të procedurës së rekrutimit në kuptim të nenit 25 të kësaj rregulloreje të parashtrij ankesë kundër procedurës së rekrutimit lidhur me pretendimet e saj ankimore siç përcaktohet me nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe pastaj të parashtrij ankesë në Këshill, ndërsa këshilla e juridike e dhënë nga Komisioni i Pranimit sipas vendimit të datës 01.08.2022 ka qenë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.746/2022

Çlirim ZEKA

Çlirim ZEKA
Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.